PROFILI MIKROBIOLOGJIK DHE NDJESHMËRIA NDAJ ANTIBIOTIKËVE E INFEKSIONEVE POSTOPERATIVE NË KIRURGJINË ENDOSKOPIKE TRANSSFENOIDALE TË HIPOFIZËS NË QSUT

MSc. Manjola Pjetri, PhD(c)[1], Prof. Asoc. Valbona Bilali[2], MSc. Klea Kazazi[1], MSc. Alma Cumraku[1], MSc. Anisa Vogli[1]

[1] Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" (QSUT), Tiranë, Shqipëri.
[2] Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri.

Autori korrespondent: MSc. Manjola Pjetri — manjolapjetri@hotmail.com

Abstrakt

Hyrje: Kirurgjia endoskopike transsfenoidale përbën standardin bashkëkohor minimalisht invaziv për trajtimin e patologjive të rajonit selar. Megjithëse redukton traumatizmin e indeve dhe periudhën e hospitalizimit, aksesi përmes kavitetit nazal dhe sinuseve paranasale e ekspozon hapësirën intrakraniale ndaj florës bakteriale endogjene. Përcaktimi i profilit mikrobiologjik dhe ndjeshmërisë ndaj antibiotikëve është thelbësor për mbikëqyrjen spitalore dhe trajtimin e targetuar të komplikacioneve infektive.

Qëllimi: Analiza e profil mikrobiologjik, spektrit të ndjeshmërisë ndaj antibiotikëve të izolates bakteriale dhe vlerësimi i faktorëve perioperativë te pacientët që i nënshtrohen kirurgjisë endoskopike transsfenoidale të hipofizës në QSUT.

Metodologjia: U krye një studim klinik observues me një kampion prej 120 pacientësh të operuar me rrugë endoskopike transsfenoidale në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" (QSUT). U analizuan me hollësi të dhënat demografike, prania e rrjedhjes së lëngut cerebro-spinal (LCR), skemat e profilaksisë antibiotike perioperative, si dhe rezultatet e kulturave mikrobiologjike (LCR, eksudate nazale) bashkë me antibiogramat përkatëse për rastet me komplikacione infektive postoperative.

Rezultatet: Në kampionin prej 120 pacientësh, incidenca e infeksioneve postoperative mbeti me normë mjaft të ulët (SSI 1.67%, meningit 4.16%). Rrjedhja intraoperative dhe postoperative e LCR-së u identifikua si faktori kryesor i rrezikut i lidhur me shfaqjen e infeksioneve. Kultura mikrobiologjike të izoluara zbuluan praninë e florës bakteriale gram-pozitive dhe gram-negative të rrugëve të sipërme respiratore. Antibiogramat treguan shkallë të lartë ndjeshmërie ndaj skemave profilaktike standarde, me raste të izoluara të rezistencës që nënvizojnë rëndësinë e protokolleve strikte të asepsisë (98%) të zbatuara nga ekipi infermieror.

Konkluzionet: Kirurgjia endoskopike transsfenoidale dëshmon siguri të lartë klinike në QSUT. Identifikimi i saktë mikrobiologjik dhe përcaktimi i antibiogramës janë me vlerë klinike për trajtimin e targetuar, ndërsa menaxhimi i rrjedhjeve të LCR-së dhe respektimi i protokolleve sterile mbeten shtyllat kryesore në parandalimin e infeksioneve.

Fjalët kyçe: *Profili mikrobiologjik, Antibiograma, Kirurgji endoskopike transsfenoidale, Hipofiza, QSUT.*